



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE  
BORDI MBIKQYRËS

Nr. 109 Prot.

Tiranë më 16.04.2021

PROCESVERBAL

**Mbledhje e Bordit Mbikqyrës të AMShC-së**

Më datë 16.04.2021 në orën 13:00, nëpërmjet platformes online zoom, sipas njoftimit u mbajt mbledhja e radhës së Bordit Mbikqyrës të AMShC-së.

Rendi i ditës, sipas njoftimit paraparak të Kryetares së Bordit Mbikqyrës ishte:

1. Paraqitja e prioriteteve të thirrjes Nr. 14 dhe diskutimi rreth tyre, të mbledhura përgjatë procesit të konsultimit publik me Organizatat e Shoqërisë Civile;
2. Mbi procesin e shpalljes së thirrjes Nr. 14;

Në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët e Bordit Mbikqyrës të AMShC-së:

1. Znj. Kozara Kati – *Kryetare e Bordit Mbikqyrës*
2. Z. Adrian Thanu – *anëtar*
3. Z. Ismail Ademi – *anëtar*
4. Z. Oltjon Muzaka – *anëtar*
5. Z. Aldo Merkoci – *anëtar*

Gjithashtu të pranishëm nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile:

1. Z. Andi Kananaj – *Drejtor Ekzekutiv*
2. Z. Erion Banushi – *Përgjegjës i Sektorit - Zhvillimi i Projekteve*

Fjalën e hapjes e mori Z Andi Kananaj Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile i cili paraqiti pranë të pranishmëve prioritet e grumbulluara nga konsultimet publike me organizatat e shoqërisë Civile në Qarqet e Republikës së Shqipërisë, të cilat i janë dërguara paraprakisht anëtarëve të bordit mbikqyrës me email.

Fjalën e mori Z. Merkoci i cili thekson se do duhet të ketë një shpërndarje të prioriteteve patjetër duke respektuar detyrimet ligjore që AMShC-ja ka, por do duhet të shpërndajmë pikat brënda prioriteteve kryesore, tek pika e shëndetësisë duket se ka shumë bullet dhe ngjan sikur fokusi kryesor është atje, ndërkohë që fokus do duhet të jenë dhe të rinjtë.

Fjalën e mori znj. Kozara Kati, Kryetare e Bordit Mbikqyrës e cila shprehet se prioritetet janë grumbulluar nga konsultimet me Organizatat e Shoqërisë Civile, ndërkohë angazhohet për të bashkëpunuar më të pranishmit për të qartësuar prioritetet dhe shpërndarjen e tyre me publikun, për të nisur më pas fazën e shpalljes së thirrjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE  
BORDI MBIKQYRËS

Fjalën e mori Z. Thano i cili e shikon në rregull paraqitjen e prioriteteve thjeshtë do duhet të orientohen pasi janë gjithëpërfshirëse.

Fjalën e mori Znj. Kozara e cila mori përsipër të rishikoj prioritete së bashku me Z. Merkoci dhe ti dërgoj ato më pas për publikim.

Fjalën e mori Z Andi Kananaj Drejtori ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, i cili sqaroi procesin e buxhetit në dispozicion për këtë thirrje dhe propozoi që shuma maksimale për financim të ishte në shifrat 1.500.000-2.000.000 (një milion e gjysëm ose dy milion), në mënyrë të tillë që tu jepet mundësi sa më shumë organizatave për të qënë fituese.

Fjalën e mori Z. Thano i cili ra dakort me Drejtorin Ekzekutiv të Amshc-së për kufirim max të shpërndarjes së fondeve për projekt, pra të jetë kufiri maksimal 1.500.000-2.000.000 milionë lekë, që të financohen sa më shumë organizata.

Fjalën e mori Znj. Kozara e cila dhe ajo ra dakort për shumën maksimale për financim dhe u angazhua nga pjesëmarrësit se do të punohet për prioritet dhe ditën e hënë do përfundohet procesi i prioriteteve për të realizuar shpalljen.

Unanimisht dhe gjithë anëtarët e tjerë të pranishëm në mbledhje, ranë dakord për shumën maksimale të financimit

Në përfundim u vendos nga pjesëmarrësit unanimisht që do të vazhdohet saktësimi mbi prioritetet si dhe shpallja e thirrjes ditën e hënë.

Takimi u mbyll rreth orës 14:00.

Mbajti procesverbalin

Paula Bero  
Specialiste